

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Qeverisja e korporatave
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti IV, Semestri II (Moduli financiar)
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Salla A3
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Artor Nuhiu
Detajet kontaktuese:	artor.nuhiu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<i>Vlera e një kompanie varet nga praktikat e mira të qeverisjes së korporatës që mbrojnë investitorët. Mbrojtja më e mirë e aksionarëve ul koston e kapitalit për shkak të reduktimit më të madh të rrezikut të biznesit. Theksi në këtë lëndë është trajtimi ndërdisiplinor i qeverisjes së korporatave nga aspekti juridik dhe biznesor. Dominimi i korporatave në ekonominë moderne ka sjellë sfida të mëdha për shoqëritë dhe për bordet e drejtorëve të ngarkuar me mbikëqyrjen e aktiviteteve të korporatave. Temat që përfshihen në këtë lëndë janë roli dhe përgjegjësitë e aksionarëve dhe drejtorëve, bordet e drejtorëve dhe menaxhmenti ekzekutiv (agjenti). Gjithashtu, politikat e kompensimit të menaxhmentit ekzekutiv, struktura dhe praktikat e qeverisjes korporative, zbulimi dhe transparenca e korporatës, dhe vlera e votës së aksionarëve. Lënda shqyrton se si transparenca, përgjegjësia, llogaridhënia dhe trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë aksionarëve ndihmojnë në përmirësimin e qeverisjes së korporatës dhe reduktimin e konflikteve të agjencisë ndërmjet aksionarëve, menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Qëllimi i lëndës është të shqyrtojë rolin e korporatës në shoqëri; evolucionin e standardeve të qeverisjes korporative në botë; struktura, përbërja, prioritetet dhe kultura e bordeve të drejtorëve; angazhimi i aksionarëve dhe palëve të interesuara, duke përfshirë përgjegjësinë sociale të korporatës. Lënda fokusohet kryesisht në trajtimin e korporatave fitimprurëse, të tregtuara publikisht. Studentët sfidohen të kuptojnë sistemin dhe strukturën në të cilën funksionojnë korporatat dhe të mendojnë në mënyrë kritike rreth kornizës për qeverisje</i>

	<i>efektive të korporatës.</i>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Në përfundim të ciklit të ligjëratave nga kjo lëndë, studentët duhet të jenë të aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të kuptojnë dhe diskutojnë në mënyrë kritike konceptet kryesore në fushën e qeverisjes së korporatës dhe përgjegjësisë sociale të korporatës;</i> - <i>Të analizojnë drejt problemet praktike të korporatave dhe të njohin problemet me të cilat ato ballafaqohen;</i> - <i>T'i kuptojnë shkaqet dhe pasojat e problemeve të agjencisë për shkak të konflikteve të interesit midis aksionarëve, bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit ekzekutiv dhe palëve të tjera të interesuara;</i> - <i>Të vlerësojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve dhe palëve të interesuara;</i> - <i>Të kuptojnë se si transparenca, përgjegjësia, llogaridhënia dhe trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë aksionarëve përbëjnë bazën e praktikave të mira të qeverisjes së korporatës.</i> - <i>Të kuptojnë rëndësinë e komitetit të auditimit, përbërjen dhe përgjegjësitë e tij;</i> - <i>Të kuptojnë praktikën më të mira në menaxhimin e korporatës.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	4	3	12
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	4	7	28
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			200 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, ushtrimeve, seminareve, diskutimeve dhe konsultimeve. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit</i></p>		

	<p>mësimor.</p> <p>Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë të inkurajuar që të shtrajnë pyetje. Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre. Nga studentët paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literaturën relevante për temat e specifikuar të lëndës.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve konsiston në dy metoda:</p> <p>1. Vlerësimi i vazhdueshëm: Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit përmes dy vlerësimeve/kollokfiumeve semestrale.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Vlerësimi/Kollokfiumi i parë:</u> 45% (fokusi në temat e ligjëratave nga javët 1-7). ▪ <u>Vlerësimi/Kollokfiumi i dytë:</u> 45% (fokusi në temat e ligjëratave nga javët 9-14). ▪ <u>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata, angazhimi në diskutime dhe prezantimi:</u> 10%. <p>2. Provimi final: Studentët që nuk kanë arritur të kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm ose nuk kanë marrë pjesë në të, duhet t'i nënshtrohen provimit final gjatë afatit të provimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Provimi final:</u> Vlerësohet me 100% dhe mbulon të gjithë materialin e ligjëruar gjatë semestrit. <p>Shënim: Studentët që zgjedhin/kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm dhe janë të kënaqur/pranojnë notën e kollokfiumit lirohen nga pjesëmarrja në provimin final.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjërata të autorizuara, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2023. 2. Bob Tricker – Corporate Governance Principles, Policies, and Practices, Second Edition, Oxford University Press, 2012. 3. Christine A. Mallin – Corporate Governance, Sixth Edition, Oxford University Press, 2019. 4. A. C. Fernando, K. P. Muraleedharan, E. K. Satheesh – Corporate Governance Principles, Policies and Practices, Third Edition, Pearson, 2018. 5. Marc Goergen – International Corporate Governance, First Edition, Pearson, 2012.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mak Yuen Teen, Richard Tan – Corporate

	<p><i>Governance Case Studies, CPA Australia Ltd., 2020.</i></p> <p>2. <i>Kodi i Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë, 2014.</i></p> <p>3. <i>Bob Tricker – The Evolution of Corporate Governance, Cambridge University Press, 2020.</i></p> <p>4. <i>Robert A. G. Monks, Nell Minow – Corporate Governance, Fifth Edition, John Wiley & Sons Ltd., 2011.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ligjëratë hyrëse- prezantimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Të kuptuarit e qeverisjes së korporatës
Java e tretë:	Palët e interesuara në qeverisjen e korporatës
Java e katërt:	Modelet e qeverisjes së korporatës në ekonomitë e zhvilluara
Java e pestë:	Qeverisja e korporatës në vendet në tranzicion
Java e gjashtë:	Korniza rregullative e qeverisjes së korporatës
Java e shtatë:	Akti Sarbanes-Oxley
Java e tetë:	<i>Vlerësimi/Kollokfiumi i parë</i>
Java e nëntë:	Praktikat e qeverisjes së korporatës
Java e dhjetë:	Përgjegjësia sociale e korporatës
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemet e kontrolleve të brendshme
Java e dymbëdhjetë:	Auditimi i brendshëm
Java e trembëdhjetë:	Rreziqet e biznesit, vlerësimi dhe kontrollet mbi rreziqet
Java e katërmëdhjetë:	Etika e biznesit dhe qeverisja korporative
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Vlerësimi/Kollokfiumi i dytë</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vonesa në ligjerata dhe ushtrime; • Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme); • Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi; • Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale. <p>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopjimi gjatë provimit ose testit; • Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit; • Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit; • Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi. 	